



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

# KURRIKULA BËRTHAMË

LËNDA: LETËRSI

KLASA: XI

Tiranë, 2016



## **PËRMBAJTJA**

I. HYRJE.....	3
II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË LETËRSISË .....	4
1. Qëllimet e arsimit parauniversitar.....	6
2. Qëllimet e programit të letërsisë .....	6
3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës .....	7
4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.....	8
5. Lidhja e letërsisë me temat ndërkurrikulare .....	14
6. Lidhja e letërsisë me fushat e tjera të të nxënit.....	15
7. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre.....	17
8. Ndarja e kohës mësimore për secilën klasë .....	19
III. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË PESTË .....	19
Klasa X.....	20
Klasa XI.....	29
IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	40
V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN .....	43
VI. ELEMENTET QË DO TË STUDIOHEN NË TEKSTET LETRARE .....	45
1. Autorët dhe veprat e sugjeruara në arsimin e mesëm e lartë .....	47
2. Leximet jashtë klase dhe bisedat letrare .....	48
VII. MATERIALET, BURIMET MËSIMORE, MJEDISËT E TË NXËNIT .....	48

## I. HYRJE

Lënda e letërsisë bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen dhe zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Letërsia është një nga lëndët kryesore në arsimin e mesëm të lartë. Ajo ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve. Kjo lëndë, gjithashtu, mundëson krijimin e një raporti pozitiv dhe të qëndrueshëm mes nxënësve dhe artit të letërsisë.

Letërsia zhvillohet nga klasa e dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë. Programi i saj mbështetet në njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që nxënësit kanë fituar në arsimin bazë. Në ciklin 9-vjeçar, letërsia mësohet e integruar me gjuhën shqipe. Në arsimin e mesëm të lartë, letërsia studiohet si veprimtari krijuese, subjektive dhe e vetëmjaftueshme. Ajo shihet e lidhur me zhvillimin historik e shoqëror, me filozofinë e kohës, por jo si mjet i thjeshtë që ilustron historinë.

Letërsia, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të cilat janë të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj.

Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së letërsisë, kompetencat e saj janë:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve <sup>1</sup>të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në arsimin bazë, nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet vazhdimisht, gjatë gjithë jetës, dhe nuk ka pikëmbërritje. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit kanë para tyre sfida

---

<sup>1</sup> Tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike

të reja. P.sh., ata njohin dhe analizojnë në mënyrë më të thelluar vepra të gjinive të ndryshme letrare (që janë në përputhje me zhvillimin e tyre), gjykojnë për periudhat dhe drejtimet e ndryshme letrare, vlerësojnë krijimtarinë letrare të autorëve të ndryshëm etj.

Programi i letërsisë bazohet në parimin e integritit të njohurive dhe në parimin e rimartjes së tyre, vit pas viti duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

## II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË LETËRSISË

Hartimi i programit të letërsisë mbështetet në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, kurrikulën bërthamë dhe në planin mësimor të gjimnazit. Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

**Mësuesit** do ta përdorin programin e letërsisë për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të përmbushur kërkesat e programit.

**Autorët e teksteve** do ta përdorin programin e letërsisë për të hartuar tekste që janë në funksion të analizës së plotë dhe funksionale të veprave dhe të autorëve.

**Prindërit dhe komuniteti** nëpërmjet programit lëndor mund të informohen për njohuritë, aftësitë dhe vlerat që marrin fëmijët e tyre në lëndën e letërsisë.

**Specialistët e arsimit** mund ta përdorin programin e letërsisë për qëllime inspektimi, vlerësimi, monitorimi, studimi etj.


**Fakultetet e mësuesisë** mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i letërsisë ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës do të realizohen edhe temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e letërsisë me lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Në program është sugjeruar edhe shpërndarja e orëve mësimore.

Diagrami e mëposhtëm paraqet organizimin e programit të letërsisë.



## **1. Qëllimet e arsimit parauniversitar**

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

## **2. Qëllimet e programit të letërsisë**

Nëpërmjet studimit të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë nxënësit:

- lexojnë dhe interpretojnë vepra e fragmente nga gjini të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- vlerësojnë rëndësinë shoqërore, historike dhe kulturore të letërsisë dhe të shkrimtarëve si krijues;
- vlerësojnë letërsinë si një mënyrë për të pasuruar botën e tyre emocionale, si dhe për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik;
- lexojnë poezi, prozë, dramë dhe dallojnë tiparet kryesore të tyre;
- analizojnë shumëllojshmërinë e mjeteve të shprehjes artistike dhe dallojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes letërsisë dhe arteve të tjera (teatër, muzikë, art pamor);
- zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre;
- gjykojnë për vlerat estetike të gjuhës në një tekst letrar;
- lidhin tekstin që lexojnë me jetën e përvojat e tyre, si dhe me botën që i rrethon;

- analizojnë tekste të ndryshme letrare dhe zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese me gojë dhe me shkrim;
- interpretojnë vlerat tërësore të veprave që marrin karakter gjithëkohor dhe që transmetojnë mesazhe përtej kohës së tyre;
- aftësohen për të qenë qytetarë të denjë për shoqërinë dhe për tregun e punës.

### **3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës**


Realizimi i kompetencave kyçe të kornizës kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënimit kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për ta përmbushur në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënimit. Kur nxënësi përmbush kompetencat e lëndës së letërsisë, ai njëkohësisht është zhvillon edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit e të komunikimit dhe zhvillon kështu, edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënimit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënimit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përcakton rezultatin e të nxënimit të kompetencave kyçe për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënimit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike dhe metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënimit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënimit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënimit për vit mësimor në

lëndën e letërsisë.

Diagrami e mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës.



#### **4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.**

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit dhe lëndëve mësimore. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” , ku bën pjesë edhe lënda e letërsisë ndihmon në realizimin e të gjitha kompetencave, por më së shumti në kompetencën e komunikimit dhe e të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.



Shkalla V	Shkalla VI
<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shprehet përmes një forme komunikimi për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material;</li> <li>- diskuton në grup në mënyrë konstruktive, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme;</li> <li>- lexon rrjedhshëm të përbërë nga 3-5 paragrafë, u përgjigjet pyetjeve të shtruar për llojin e tekstit dhe stilin e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve;</li> <li>- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe në forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, email (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në një gjuhë të huaj ose në gjuhën amtare, si dhe tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së asaj gjuhe me gjuhën amtare;</li> <li>- shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me tre deri pesë paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;</li> <li>- shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të esesë;</li> <li>- prezanton një projekt artistik, humanitar,</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpreh para një audience të caktuar mësimore çështjet kryesore të ngritura në një fjalim ose interpretim të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes të paktën një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike) etj.;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të panjohur në gjuhën e huaj, i cili përmban 2-3 faqe (p.sh., tregim letrar, tekst argëtues, artikull gazete ose reviste etj.), identifikon ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në strukturën e fjalive në gjuhën e huaj dhe në gjuhën amtare, duke nënvizuar dhe duke ilustruar me shembuj konkretë;</li> <li>- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, email, letër formale dhe joformale etj.;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafësh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin dhe leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që bart secili paragraf;</li> <li>- prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe komunikon në mënyrë efektive me audiencë duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike;</li> <li>- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimi me gojë e me</li> </ul>

<p>eksperimentues etj.) për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënësit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.</li> </ul>	<p>shkrim, të artit pamor, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar si p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;</li> <li>- përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënies dhe kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të menduarit</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e mbledhjes, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar;</li> <li>- ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.);</li> <li>- krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e temës, argumenton saktësinë dhe rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kritere të përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;</li> <li>- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve;</li> <li>- analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë, p.sh., orientimi në karrierë, integrimet evropiane, ndryshimet klimatike, rreziqet nga armët konvencionale, armatimi bërthamor, zhvillimi kulturor-artistik në vend etj.);</li> <li>- hulumton, në mënyrë të pavarur, për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit;</li> <li>- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën</li> </ul>

<p>të ndryshme të të shprehurit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.</li> </ul>	<p>e duhur për të zgjidhur një problem, duke dhënë shembuj konkretë.</p>
<b>Kompetenca e të nxënit</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;</li> <li>- shfrytëzon, në mënyrë efektive, përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore;</li> <li>- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e mëtejshëm;</li> <li>- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burime të tjera informacioni për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat, më pas, i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;</li> <li>- kërkon dhe shfrytëzon në mënyrë të duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe më pas prezanton rezultatet e arritura;</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.);</li> <li>- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë mësimore të re (ose një problem nga jeta e përditshme, ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarë); tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla;</li> <li>- shfrytëzon, në mënyrë të duhur, këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;</li> <li>- përpunon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, informacionet për një temë të caktuar; rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.</li> <li>- paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritshme (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.);</li> <li>- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime informacioni në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).</li> </ul>	<p>studimit dhe e paraqet para të tjerëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka përdorur për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;</li> <li>- vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.;</li> <li>- menaxhon, në mënyrë produktive, burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/punës etj.), gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.</li> </ul>
--	--

### Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer përvojë, duke u konsultuar me të tjerët dhe duke i informuar ata, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;</li> <li>- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, komuniteti dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.);</li> <li>- diskuton me të tjerët për procesin e organizimit dhe për rezultatet e arritura, si dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre dhe si të rritet</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- paraqet, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillim të karrierës në një fushë të caktuar;</li> <li>- merr nisma të suksesshme për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.</li> </ul>
---	--

pjesëmarrja në aktivitete.	
<b>Kompetenca personale</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe menaxhon, në mënyrë konstruktive, emocionet e veta;</li> <li>- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon shkathtësi në organizimin e lojërave me të tjerët, garave sportive, apo aktiviteteve kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë aktiviteteve dhe gjatë jetës së përditshme;</li> <li>- prezanton, në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh., në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen;</li> <li>- shpreh në forma të ndryshme qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.</li> </ul>
<b>Kompetenca qytetare</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, në lokal dhe në nivel shtetëror); tregon, gjatë diskutimit, tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;</li> <li>- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton, në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;</li> <li>- paraqet, në forma të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;</li> <li>- merr pjesë në proceset demokratike të</li> </ul>

<p>gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.</li> </ul>	<p>vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.</p>
<b>Kompetenca digjitale</b>	
<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;</li> <li>- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet paraqitjeve filmike apo të animuara;</li> <li>- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;</li> <li>- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe bashkëpunuar me bashkëmohatarët gjatë procesit të të nxënimit, duke përfshirë edhe të nxënimit në distancë;</li> <li>- vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;</li> <li>- është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënimit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.</li> </ul>

## 5. Lidhja e letërsisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë një mënyrë për të integruar kompetencat kyçe në fushat e të nxënimit ose lëndët mësimore. Ato janë çështje të rëndësishme, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Trajtimi i temave ndërkurrikulare i ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.

- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Letërsia, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore që mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme letrare nga letërsia shqipe dhe botërore zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar dhe njohjen e vlerësimin e kulturës botërore. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup në orë të ndryshme mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata të nxëni, gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e letërsisë, ndihmojnë në aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

## **6. Lidhja e letërsisë me fushat e tjera të të nxënit**

Lënda e letërsisë lidhet me shumë lëndë të arsimit të mesëm të lartë. Natyrisht, letërsia ka lidhje, më së shumti, me lëndët që përbëjnë fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, pra me gjuhën shqipe dhe me gjuhën e huaj. Ekzistenca e letërsisë dëshmohet pikërisht nëpërmjet gjuhës si materie kryesore dhe jashtë saj, ajo nuk mund të krijohet, të ekzistojë, të komunikojë dhe as të ndikojë estetikisht. Nga ana tjetër, letërsia përbën një material të rëndësishëm për gjuhësinë, pasi i shërben si objekt analize dhe dëshmi e shfaqjes së dukurive të ndryshme gjuhësore në periudha të ndryshme kohore.

Studimi i veprave të disa autorëve të letërsisë botërore mund të zgjojë te nxënësit interes për gjuhën dhe kulturën e atij vendi, duke zbuluar kështu një nga lidhjet mes letërsisë dhe gjuhës së huaj.

Studimi i letërsisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të vlerësojnë natyrën. Shpesh natyra dhe bukuritë e saj shërbejnë si burim frymëzimi për shkrimtarët. Leximi dhe studimi i këtyre krijimeve artistike tërheq vëmendjen e nxënësve drejt bukurive dhe vlerave të natyrës. Kjo do të thotë që kjo lëndë mund të integrohet me shkencat e natyrës dhe me lëndët që përfshihen në këtë fushë.

Letërsia si lëndë mësimore mbështet studimin e shkencave shoqërore në mënyra të ndryshme. Leximi i veprave letrare ndikon në formimin dhe ndryshimin e botëkuptimeve, në kuptimin e ngjarjeve dhe të personaliteteve historike, si dhe në orientimin në jetën shoqërore dhe në marrëdhëniet njerëzore. Shpeshherë, letërsia është parë si një nga format e shprehjes së mendimit filozofik. Krijimtaria letrare ka qenë një mundësi e mirë për shprehjen e ideve filozofike. Mjaft shkrimtarë kanë qenë edhe filozofë të mëdhenj, si p.sh.: Volteri, Shiler, Niçe, Sartri, Kamy etj. P.sh., ekzistencializmi i Kamysë dhe i Sartrit ka gjetur shprehje jo vetëm në traktate filozofike, por edhe në krijimtarinë e tyre letrare.


Artet dhe studimi i tyre mbështeten nga studimi i letërsisë (si një nga artet). Analiza e veprave letrare mbështet kuptimin e “mjetit artistik”, si një term i përbashkët i të gjithave arteve, i cili përdoret nga artistët për të përcjellë mesazhet e tyre. Analiza e ilustrimeve (pamje, piktura etj.) në vepra të ndryshme letrare dhe shpjegimi i funksioneve të tyre mbështen kuptimin e specifikave të arteve të bukura dhe mjeteve të tyre të shprehjes. Ilustrimi i analizave letrare me muzikën e një periudhe të caktuar i ndihmon nxënësit që të kuptojnë efektin emocional të muzikës, si dhe karakteristikat e veçanta të rrymave të ndryshme muzikore.

Kjo do të thotë që zbatuesit e këtij programi (më së shumti, mësuesit) duhet të realizojnë parimin e integritit të letërsisë me njohuri, aftësi dhe shkathtësi të lëndëve të tjera, të tilla si: Gjuhë shqipe, Arte, Gjuhët e huaja, Teknologji, Shkenca shoqërore etj.

Më lart është përshkruar ndikimi ose mbështetja e letërsisë në funksion të fushave ose lëndëve të tjera mësimore. Lënda e letërsisë, jo vetëm mbështet, por edhe përdor njohuri dhe aftësi që nxënësit kanë marrë në fushat/ lëndët e tjera.

Më konkretisht, këto njohuri dhe aftësi janë dhënë në diagramin e mëposhtëm:





## 7. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Lënda e letërsisë synon të formojë dhe zhvillojë te nxënësit dy kompetenca:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për zhvillimin e këtyre kompetencave nuk duhet të bëhet e ndarë dhe e fragmentarizuar. Në procesin mësimor, gjatë çdo ore mësimore punohet për formimin e të dyja kompetencave.

Kështu p.sh., nxënësi analizon dhe interpreton një poemë të Bajronit me të gjitha veçoritë e saj

dhe, gjithashtu, gjykon dhe vlerëson tiparet kryesore të krijimtarisë së Bajronit dhe të letërsisë romantike. Pra, nxënësi e studion veprën në thellësi, por edhe raportin e saj me krijimtarinë e autorit dhe me periudhën letrare ose historike.

### **Përshkrimi i kompetencave**

#### **a) Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.**

Nxënësit fitojnë teknikën e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë, si lexues kritikë dhe të pavarur, vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësi nuk i mëson thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe tekste në prozë.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura.

#### **b) Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.**

Nxënësit krijojnë një pasqyrë të qartë:

- të fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe botërore;
- të lidhjeve mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare;
- të gjinive letrare, të autorëve dhe veprave më përfaqësuese të një periudhe historike ose drejtimi letrar.

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, mësimi i letërsisë përqendrohet në karakteristikat kryesore të një periudhe, duke u dhënë mundësi nxënësve të krijojnë një ide të përgjithshme rreth origjinës, përhapjes dhe tipareve të një drejtimin letrar, si dhe të gjinive e llojeve që lëvrohen.

Përzgjedhja e veprave letrare që studiohen përgjatë tri viteve, bëhet duke respektuar një raport të drejtë mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore. Letërsia shqipe do të studiohet paralelisht me letërsinë botërore duke u kushtuar vëmendje të përbashkëtave dhe dallimeve mes tyre. Në këtë

mënyrë, nxënësit do të kuptojnë që letërsia shqipe nuk është një njësi e veçuar dhe e ndarë, por pjesë pasurisë letrare botërore.

### 8. Ndarja e kohës mësimore për secilën klasë

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për shkallën e pestë dhe për shkallën e gjashtë (klasat X-XII).

Klasa/ shkalla	X	XI	Shkalla V	XII	Shkalla VI
Orë/javë	2	2	4	2	2
Orë gjithsej	72	72	144	68	68

Koha mësimore përdoret për:

- njohuri të reja;
- përsëritje;
- dramatizime;
- biseda letrare;
- testime;
- ese;
- projekte etj.

Analiza dhe studimi i veprave letrare që janë sugjeruar në program (së bashku me jetën dhe veprimtarinë e autorit) sugjerohet që të zhvillohen në jo më pak se **5 orë mësimore**. Në lëndën e letërsisë, gjatë çdo orë mësimi nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë të dyja kompetencat lëndore.

## III. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË PESTË



## Klasa X

### **KOMPETENCA: ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TEKSTEVE TË GJINIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME LETRARE**

#### **Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë**

Nxënësi:

- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti;
- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik si: motivet kryesore, përdorimi i gjuhës, figuracioni, rima, ritmi, llojet e strofës etj.;
- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik si: trajtimi i temës, konfliktet e përshkruara në vepër, analiza e marrëdhënieve mes personazheve etj.;
- dallon gjinitë kryesore, si dhe tiparet e çdo gjinie letrare.

<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë <sup>2</sup></b>
<b>Letërsia dhe gjinitë letrare</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Funkzioni dhe vlera e letërsisë. Shkenca për letërsinë.</li><li>- Lidhja e letërsisë me artet e tjera.</li><li>- Ndarja letërsisë sipas gjinive dhe tiparet e tyre.</li><li>- Karakteristikat kryesore të mitit, legjendës, poemës epike, tragjedisë, komedisë</li></ul>	<b>Letërsia dhe gjinitë letrare</b> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- analizon funksionet dhe vlerat e letërsisë si lloj arti;</li><li>- përcakton objektin e studimit të shkencës për letërsinë dhe analizon drejtimet kryesore të kësaj shkence;</li><li>- analizon lidhjet e letërsisë me artet e tjera;</li><li>- përcakton gjininë letrare së cilës i përket një vepër;</li><li>- evidenton tiparet kryesore të gjinisë epike, lirike dhe dramatike dhe të nënlojeve të tyre;</li><li>- analizon karakteristikat e një miti, legjende, poeme, tragjedie, komedie dhe romani (vepra që studiohen të plota</li></ul>

<sup>2</sup> Veprat për të cilat nxënësit do të marrin njohuri dhe do të demonstrojnë shkathtësi, vlera ose qëndrime janë dhënë në një tabelë në fund të programit.

<p>dhe romanit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Figuracioni letrar: epiteti, antiteza, krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, metonimia, anafora.</li> </ul> <p><b>Elementet e tekstit letrar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fabula, subjekti.</li> <li>- Personazhet.</li> <li>- Tema dhe motivet e veprës letrare.</li> <li>- Mjedisi, koha dhe atmosfera.</li> <li>- Stili dhe gjuha.</li> </ul>	<p>gjatë klasës së dhjetë).</p> <p><b>Elementet e tekstit letrar:</b></p> <p><b>a) Fabula dhe subjekti</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon me fjalët e tij subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;</li> <li>- përcakton fabulën e një teksti;</li> <li>- dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të një teksti;</li> <li>- dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon rëndësinë e tyre;</li> <li>- dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;</li> <li>- analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;</li> <li>- përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori (p.sh., një tregim është shkruar në formën e një letre, në një novelë jepen ngjarjet në rend kronologjik etj.).</li> </ul> <p><b>b) Personazhet</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>- shpjegon rolin dhe qëllimet e personazheve;</li> <li>- analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;</li> <li>- evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);</li> <li>- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër;</li> <li>- dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar,</li> </ul>
--	---

mitologjikë, kryesorë, dytësorë);

- shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;
- analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve.

#### **c) Mjedisi, koha dhe atmosfera**

Nxënësi:

- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);
- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.

#### **d) Tematika**

Nxënësi:

- dallon temën dhe motivet e një teksti;
- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar;
- demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës.

#### **e) Stili dhe gjuha**

Nxënësi:

- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.:
  - gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve);
  - përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.);
  - muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.);
  - rrëfimtari dhe veta e rrëfimit (veta e parë, veta e tretë);
  - toni (i gjallë, i zyrtarë, i ngrohtë, i solemn);

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjatësia e fjalive, elipsa, asindetit etj.;</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara.</li> </ul> <p><b>Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;</li> <li>- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.</li> </ul> <p><b>Lidhja mes tekstit dhe lexuesit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst;</li> <li>- tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> </ul> <p><b>Reflektimi ndaj tekstit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;</li> <li>- reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>- shprehet, në mënyra të ndryshme, për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj.</li> </ul> <p><b>Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj</li> </ul>
--	---

	<p>nga teksti;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> </ul>
--	---

### **Vlerat dhe qëndrimet**

Nxënësi:

- komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët;
- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;
- respekton mendimin e të tjerëve;
- demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin;
- ndërmerr iniciativa dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënit;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;
- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;
- është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- kritikon duke u mbështetur mbi argumente;
- tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.

### **KOMPETENCA: VLERËSIMI I LETËRSISË SHQIPE DHE BOTËRORE NË PERIUDHA TË NDRYSHME LETRARE**

#### **Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë**

Nxënësi:



<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon tiparet kryesore të folklorit tonë, përshkruan origjinën dhe përmbajtjen e eposit kombëtar dhe vlerëson rëndësinë historike dhe kulturore të tij;</li> <li>- analizon tiparet kryesore të letërsisë antike greke dhe romake, të letërsisë së Rilindjes Evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit; përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues;</li> <li>- krahason vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore;</li> <li>- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.</li> </ul>	
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë</b>
<p><b>FOLKLORI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tiparet dhe vlerat e folklorit.</li> <li>- Llojet e krijimtarisë gojore.</li> <li>- Vlerat e lirikës popullore.</li> <li>- Epika popullore, nëndarjet, vlerat e saj.</li> </ul>	<p><b>FOLKLORI (Eposi “Cikli i kreshnikëve”)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon tiparet e folklorit dhe vlerat e tij;</li> <li>- përcakton ndarjet e lirikës popullore;</li> <li>- analizon dhe gjykon për vlerat e lirikës popullore;</li> <li>- përcakton ndarjet e epikës popullore;</li> <li>- analizon dhe gjykon për vlerat e epikës popullore.</li> </ul>
<p><b>ANTIKITETI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vështrim i përgjithshëm për letërsinë greke dhe latine.</li> <li>- Lindja dhe lulëzimi i epikës, lirikës dhe dramatikës.</li> <li>- Karakteristikat e secilës gjini letrare.</li> <li>- Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore.</li> </ul>	<p><b>ANTIKITETI</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson rëndësinë e letërsisë greko-romake, si dhe analizon sfondin historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi;</li> <li>- veçon llojet dhe gjinitë letrare që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe, si dhe përfaqësuesit dhe veprat kryesore.</li> </ul>

<p><b>Homeri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çështja homerike.</li> <li>- Rëndësia e Homerit në letërsinë e mëvonshme.</li> </ul>	<p><b>Homeri (poema “Iliada”)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton për hipotezat e ndryshme në lidhje me ekzistencën e Homerit dhe veprën e tij;</li> <li>- vlerëson rëndësinë e Homerit në letërsinë e mëvonshme.</li> </ul>
<p><b>Eskili</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jeta dhe krijimtaria e Eskilit.</li> <li>- Tiparet dalluese të krijimtarisë së Eskilit.</li> </ul>	<p><b>Eskili (tragjedia “Prometeu i mbërthyer” )</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Eskilit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Eskilit;</li> <li>- analizon tiparet dalluese të krijimtarisë së Eskilit.</li> </ul>
<p><b>Euripidi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jeta dhe veprat e Euripidit.</li> <li>- Tiparet karakteristike të tragjeditë të Euripidit.</li> </ul>	<p><b>Euripidi</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Euripidit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Euripidit;</li> <li>- analizon tiparet karakteristike të tragjeditë të tij;</li> <li>- vlerëson risitë që solli Euripidi në letërsinë antike greke.</li> </ul>
<p><b>RILINDJA EVROPIANE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vështrim i përgjithshëm rreth zhvillimit të Humanizmit dhe të Rilindjes Europiane si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike.</li> <li>- Filozofia dhe zhvillimi i saj.</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë në Europë.</li> </ul>	<p><b>RILINDJA EVROPIANE</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- diskuton rreth zhvillimit të Humanizmit dhe të Rilindjes Europiane si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike;</li> <li>- veçon përfaqësuesit kryesorë të kësaj epoke në Europë.</li> </ul>

<p><b>Aligeri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dhëna biografike të Aligerit dhe krijimtaria e tij.</li> <li>- “Komedia Hyjnore” dhe rëndësia e kësaj vepre.</li> </ul>	<p><b>Dante Aligeri (pjesa I, “Ferri”)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Aligerit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Aligerit;</li> <li>- diskuton rreth vlerave, strukturës, filozofisë dhe rëndësisë së “Komedisë hyjnore”.</li> </ul>
<p><b>Barleti</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës dhe krijimtarisë së Marin Barletit.</li> <li>- Vendi që zë Barleti në kulturën dhe historinë tonë.</li> </ul>	<p><b>Marin Barleti (vepra “Histori e Skënderbeut”)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Barletit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- vlerëson figurën dhe kontributin e Marin Barletit.</li> </ul>
<p><b>Letërsia e vjetër shqipe</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vështrim i përgjithshëm.</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë dhe veprat e tyre.</li> </ul>	<p><b>Letërsia e vjetër shqipe (Bogdani “Këngët e sibilave” dhe disa poezi të Budit)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon kushtet historike dhe kulturore në të cilat u shkrua letërsia e vjetër shqipe;</li> <li>- veçon dhe vlerëson përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së vjetër shqipe dhe krijimtarinë e tyre letrare.</li> </ul>
<p><b>Servantes</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës, krijimtaria dhe rëndësia e Servantesit.</li> <li>- Rilindja dhe Servantesi.</li> <li>- Donkishotizmi.</li> </ul>	<p><b>M. de Servantes (romani “Don Kishoti i Mançës”)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Servantesit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Servantesit;</li> <li>- gjykon për mënyrën se si filozofia e Rilindjes gjen shprehje në krijimtarinë e Servantesit.</li> </ul>

<p><b>Shekspir</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jeta dhe veprimtaria letrare e Shekspirit.</li> <li>- Rëndësia e Shekspirit në historinë e letërsisë.</li> </ul>	<p><b>Shekspir (tragjedia “Hamleti”)</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Shekspirit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Shekspirit;</li> <li>- diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Shekspirit në letërsinë botërore.</li> </ul>
<p><b>Klasicizmi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vështrim i përgjithshëm.</li> <li>- Tiparet dhe parimet estetike.</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë.</li> <li>- Elemente të klasicizmit në letërsinë shqipe (Ethem Haxhiademi).</li> </ul>	<p><b>Klasicizmi</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon kushtet historike, shoqërore dhe kulturore që çuan në lindjen dhe zhvillimin e klasicizmit;</li> <li>- analizon tiparet dhe parimet estetike të klasicizmit;</li> <li>- veçon përfaqësuesit kryesorë të klasicizmit dhe veprat e tyre më përfaqësuese;</li> <li>- veçon disa elemente të klasicizmit në krijimtarinë e Ethem Haxhiademit.</li> </ul>
<p><b>Molier</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës, krijimtaria e Molierit.</li> <li>- Risitë që solli Molieri.</li> </ul>	<p><b>Molier (komedia “Tartufi” )</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Molierit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Molierit;</li> <li>- diskuton rreth risive që solli Molieri në letërsinë botërore.</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- komunikon mirë dhe në mënyrë korrekte me të tjerët;</li> <li>- përfshihet në diskutime duke dhënë kontributin e tij;</li> </ul>	

- respekton mendimin e të tjerëve
- demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin;
- ndërmerri iniciativë dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;
- përdori imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- përdori teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënës;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;
- përdori dhe vlerësoi gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;
- është i pavarur në vendimmarrje dhe në veprime;
- bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme;
- kritikon duke u mbështetur mbi argumente;
- tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.

## **Klasa XI**

### **KOMPETENCA: ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TEKSTEVE TË GJINIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME LETRARE**

#### **Rezultatet e të nxënës për këtë kompetencë**

Nxënësi:

- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti;
- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik si: motivet kryesore, përdorimi i gjuhës, figuracioni, rima, ritmi, llojet e strofës etj.;
- analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik si: trajtimi i temës, konfliktet e përshkruara në vepër, analiza e marrëdhënieve mes personazheve etj.;

- dallon gjinitë kryesore, si dhe tiparet e çdo gjinie letrare.	
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë <sup>3</sup></b>
<p><b>Letërsia dhe gjinitë letrare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Karakteri historik i gjinive letrare.</li> <li>- Veçoritë e llojeve të gjinisë epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani.</li> <li>- Veçoritë e llojeve të gjinisë lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne.</li> <li>- Veçoritë e llojeve të gjinisë dramatike, si: tragjedia, komedia, drama.</li> </ul> <p><b>Figurat stilistike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Figurat e kuptimit: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi figurativ.</li> <li>- Figurat e shqiptimit poetik: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofeja, aliteracioni.</li> <li>- Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve: metafora, metonimia, sinekdoka,</li> </ul>	<p><b>Letërsia dhe gjinitë letrare</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton dhe analizon zhvillimin historik të gjinive letrare;</li> <li>- dallon dhe analizon veçoritë e llojeve epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani;</li> <li>- dallon dhe analizon veçoritë e llojeve lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne;</li> <li>- dallon dhe analizon veçoritë e llojeve dramatike, si: tragjedia, komedia, drama.</li> </ul> <p><b>Figurat stilistike</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon figurat e kuptimit, si: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi figurativ;</li> <li>- analizon funksionin e figurave të kuptimit;</li> <li>- dallon figurat e shqiptimit poetik, si: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofeja, aliteracioni;</li> <li>- analizon funksionin e figurave të shqiptimit poetik;</li> <li>- dallon figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, si: metafora, metonimia, sinekdoka, ironia, sarkazma, alegoria, eufemizmi;</li> <li>- analizon funksionin e figurave fjalëve dhe të shprehjeve;</li> <li>- dallon figurat e sintaksës poetike, si: anasjella (inversioni), enumeracioni, shkallëzimi, elipsa, asindet, polisindet;</li> <li>- analizon funksionin e figurave të sintaksës poetike;</li> </ul>

<sup>3</sup> Veprat për të cilat nxënësit do të marrin njohuri dhe do të demonstrojnë shkathtësi, vlera ose qëndrime janë dhënë në një tabelë në fund të programit.

<p>ironia, sarkazma, alegoria, eufemizmi.</p> <p>- Figurat e sintaksës poetike: anasjella (inversioni), enumeracioni, shkallëzimi, elipsa, asindet, polisindet.</p>	<p>- përdor figurat stilistike në ese dhe punë të ndryshme.</p> <p><b>Elementet e tekstit letrar:</b></p> <p><b>a) Fabula dhe subjekti</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rrëfen subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;</li> <li>- përcakton dhe analizon fabulën e një teksti;</li> <li>- analizon ngjarjet kryesore të një teksti;</li> <li>- dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre;</li> <li>- dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;</li> <li>- analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;</li> <li>- analizon rolin e didaskalive në tekste dramatike;</li> <li>- përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori;</li> <li>- shpjegon efektet e teknikave të tilla në organizimin ose strukturën e tekstit letrar, si p.sh., dukurinë e anakronisë flashback-ut, paralajmërimit etj.</li> </ul> <p><b>b) Personazhet</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon dhe vlerëson personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;</li> <li>- analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;</li> <li>- evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);</li> <li>- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi</li> </ul>
---	---

	<p>që ka një personazh të një personazh tjetër;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, të jashtëzakonshëm, kryesorë, dytësorë);</li> <li>- shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;</li> <li>- analizon kompleksitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve.</li> </ul> <p><b>c) Mjedisi, koha dhe atmosfera</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare;</li> <li>- veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën;</li> <li>- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.</li> </ul> <p><b>d) Tematika</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon temën dhe motivet e një teksti;</li> <li>- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar;</li> <li>- demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës.</li> </ul> <p><b>e) Stili dhe gjuha</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst;</li> <li>- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti.</li> </ul> <p><b>Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjykon rreth kontekstit historik, kulturor, ekonomik,</li> </ul>
--	---



	<p>politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.</li> </ul> <p><b>Lidhja mes tekstit dhe lexuesit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst;</li> <li>- tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> </ul> <p><b>Reflektimi ndaj tekstit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme;</li> <li>- reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit, krahasimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>- shprehet, në mënyra të ndryshme, për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj.</li> </ul> <p><b>Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>- organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përfshihet në diskutime rreth letërsisë duke dhënë kontributin e tij;</li> <li>- demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin;</li> <li>- ndërmerri iniciativa dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme;</li> </ul>	

- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënit;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;
- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;
- kritikon duke u mbështetur mbi argumente;
- tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.

**KOMPETENCA: VLERËSIMI I LETËRSISË SHQIPE DHE BOTËRORE NË PERIUDHA TË NDRYSHME LETRARE**

**Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë**

Nxënësi:

- analizon tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit, përcakton periudhën historike në të cilën u zhvilluan këto drejtime ose periudha letrare, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues;
- krahason vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore;
- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.

**Njohuritë**

**Shkathtësitë**

**Romantizmi**

- Kushtet historike e shoqërore, në të cilat lindi dhe u zhvillua romantizmi.
- Shtirirja kohore dhe vendet, në të cilat u zhvillua romantizmi (Angli, Francë, Gjermani, Itali dhe SHBA).
- Tiparet e romantizmit.

**Romantizmi**

Nxënësi:

- analizon kushtet historiko - shoqërore, në të cilat lindi dhe u zhvillua romantizmi;
- përcakton kufinj të kohorë, në të cilët u zhvillua romantizmi, si dhe vendet ku u përhap;
- identifikon dhe analizon tiparet e romantizmit, si

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjinitë dhe llojet letrare që solli romantizmi në letërsi.</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë të romantizmit.</li> </ul>	<p>dhe i konkretizon ato në vepra të caktuara të letërsisë romantike;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- sintetizon vlerat themelore të romantizmit;</li> <li>- përcakton gjinitë dhe llojet letrare të preferuara për shkrimtarët romantikë;</li> <li>- identifikon përfaqësuesit kryesorë të romantizmit në vende të ndryshme të Evropës.</li> </ul>
<p><b>Gëte</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizja kulturore “Stuhi dhe vrull”.</li> <li>- Rëndësia e Gëtes në historinë shpirtërore dhe letrare të Gjermanisë dhe të Evropës.</li> <li>- Gëte poet, prozator dhe dramaturg.</li> <li>- Tragjedia “Fausti”.</li> </ul>	<p><b>Gëte “Fausti”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjykon për risitë që solli “Stuhi dhe vrull” dhe në letërsinë gjermane, si dhe përfaqësuesit kryesorë të kësaj lëvizjeje;</li> <li>- vlerëson rëndësinë që ka krijimtaria e Gëtes në letërsinë gjermane dhe më gjerë;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Gëtes në poezi, prozë dhe dramë;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson tragjedinë “Fausti”.</li> </ul>
<p><b>Hygo</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Franca e shekullit XIX dhe lidhjet e Hygoit me shekullin e tij.</li> <li>- Hygoi si prijës i romantizmit.</li> <li>- Hygoi si poet, prozator dhe dramaturg.</li> <li>- Romani “Katedralja e Parisit” dhe mesazhet humaniste të kësaj vepre.</li> </ul>	<p><b>Hygo “Katedralja e Parisit”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon kontributin e Hygoit në Francën e shekullit XIX;</li> <li>- vlerëson rolin e Hygoit në letërsinë romantike dhe në letërsinë e mëvonshme franceze;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Hygoit në poezi, dramë dhe prozë;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Katedralja e Parisit”.</li> </ul>
<p><b>Bajron</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jeta dhe vepra e Bajronit në raport</li> </ul>	<p><b>Bajron “Shtegtimet e Çajld Harold”</b></p> <p>Nxënësi:</p>

<p>me kohën e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimtaria letrare e Bajronit dhe romantizmi i tij.</li> <li>- Poema “Shtegtimet e Çajld Haroldit”.</li> <li>- Shqipëria dhe shqiptarët e veprën e Bajronit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon raportin mes Bajronit dhe realitetit moral, shoqëror dhe politik të kohës;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Bajronit;</li> <li>- identifikon tiparet e romantizmit që gjejnë shprehje në veprën e Bajronit;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poemën “Shtegtimet e Çajld Haroldit”;</li> <li>- gjykon dhe vlerëson mënyrën e përshkrimit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në veprën e Bajronit.</li> </ul>
<p><b>Romantizmi shqiptar</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet historike, politike dhe shoqërore, në të cilat u zhvillua romantizmi në Shqipëri.</li> <li>- Rilindja Kombëtare.</li> <li>- Romantizmi arbëresh, si degë e rëndësishme e romantizmit shqiptar.</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë të romantizmit shqiptar.</li> <li>- Gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë romantike shqiptare.</li> </ul>	<p><b>Romantizmi shqiptar</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon kushtet historike dhe shoqërore, në të cilat u zhvillua romantizmi;</li> <li>- vlerëson rolin e Rilindjes Kombëtare në funksion të çështjes kombëtare;</li> <li>- gjykon për vlerat artistike të romantikëve arbëreshë;</li> <li>- analizon veçantitë dhe të përbashkëtat mes romantizmit arbëresh dhe romantikëve shqiptarë;</li> <li>- veçon përfaqësuesit kryesorë të romantizmit arbëresh;</li> <li>- indentifikon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë romantike;</li> <li>- krahason tiparet e romantizmit shqiptar dhe romantizmit evropian.</li> </ul>
<p><b>De Rada</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Roli dhe rëndësia e De Radës në letërsinë arbëreshe të Rilindjes.</li> <li>- Krijimtaria letrare e De Radës.</li> </ul>	<p><b>De Rada “Këngët e Milosaos”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson rolin dhe rëndësinë e De Radës në letërsinë arbëreshe të Rilindjes;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Poema “Këngët e Milosaos”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- veçon veprat letrare më të rëndësishme të De Radës;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poemën “Këngët e Milosaos”;</li> <li>- dallon tiparet e romantizmit që gjejnë shprehje në veprën e De Radës;</li> <li>- analizon dhe krahason heroin romantik shqiptar dhe heroin romantik evropian.</li> </ul>
<p><b>N. Frashëri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Naim Frashëri, figura më përfaqësuese e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kontributi i tij në çështjen kombëtare, si dhe në gjuhën e në letërsinë shqipe.</li> <li>- Krijimtaria letrare e Naim Frashërit.</li> <li>- Vëllimi poetik “Lulet e verës”.</li> </ul>	<p><b>N. Frashëri “Lulet e verës”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson kontributin e Naim Frashërit në çështjen kombëtare dhe në lëvrimin e gjuhës shqipe;</li> <li>- identifikon veprat letrare të Naim Frashërit;</li> <li>- dallon tiparet e romantizmit që gjejnë shprehje në veprën e Naim Frashërit;</li> <li>- interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të vëllimit poetik “Lulet e verës”.</li> </ul>
<p><b>Realizmi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet historike dhe shoqërore, në të cilat lindi dhe u zhvillua realizmi.</li> <li>- Përhapja e realizmit në vende të ndryshme (Francë, Rusi, Angli etj.).</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë të realizmit.</li> <li>- Parimet në të cilat mbështetet letërsia realiste.</li> <li>- Gjinitë dhe llojet letrare e letërsisë realiste.</li> </ul>	<p><b>Realizmi</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon kushtet historike dhe shoqërore, në të cilat lindi dhe u zhvillua realizmi;</li> <li>- identifikon përhapjen e realizmit në vende të ndryshme të Evropës, si dhe përfaqësuesit kryesorë të letërsisë realiste;</li> <li>- dallon dhe analizon parimet në të cilat mbështetet letërsia realiste;</li> <li>- përcakton gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan më shumë nga shkrimtarët realistë.</li> </ul>
<p><b>Balzak</b></p>	<p><b>Balzak “Xha Gorio”</b></p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia e veprës së Balzakit në epokën e prozës realiste.</li> <li>- Veprat kryesore letrare të Balzakit.</li> <li>- Romani “Xha Gorio”.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon dhe vlerëson rëndësinë e veprës së Balzakit në letërsinë franceze dhe më gjerë;</li> <li>- gjykon për rëndësinë e lidhjes së veprës letrare me realitetin dhe problematikën e tij;</li> <li>- përcakton veprat kryesore të Balzakit dhe rëndësinë e tij në lëvrimin e romanit, si lloj letrar;</li> <li>- interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të romanit “Xha Gorio”;</li> <li>- identifikon karakteristikën e personazhit realist në këtë roman.</li> </ul>
<p><b>Flober</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia që solli Floberi në letërsinë në planin e tematikës, subjektit, personazheve dhe stilit.</li> <li>- Krijimtaria letrare e Floberit.</li> <li>- Romani “Zonja Bovari”.</li> <li>- Bovarizmi.</li> </ul>	<p><b>Flober “Zonja Bovari”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon rëndësinë që solli Floberi në letërsinë në planin e tematikës, subjektit, personazheve dhe stilit;</li> <li>- përcakton veprat kryesore letrare të Floberit;</li> <li>- interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të romanit “Zonja Bovari”;</li> <li>- përcakton se çfarë është “Bovarizmi” dhe tregon se çfarë konflikti shpreh.</li> </ul>
<p><b>Dostojevski</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faktorët ideologjikë, shoqërorë dhe biografikë që ndikuan në krijimtarinë letrare të Dostojevskit.</li> <li>- Krijimtaria letrare e Dostojevskit.</li> <li>- Rëndësia që solli dhe ndikimi i tij në letërsinë e shekullit XX.</li> <li>- Romani “Vëllezërit Karamazovë”.</li> </ul>	<p><b>Dostojevski “Vëllezërit Karamazovë”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon faktorët ideologjikë, shoqërorë dhe biografikë që ndikuan në krijimtarinë letrare të Dostojevskit;</li> <li>- përcakton veprat kryesore letrare të Dostojevskit;</li> <li>- analizon dhe vlerëson rëndësinë që solli Dostojevski</li> </ul>

	<p>në letërsi, si dhe ndikimet që pati krijimtaria e tij në letërsinë e shekullit XX;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të romanit “Vëllezërit Karamazovë”.</li> </ul>
<p><b>Letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XX</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i rrymave të reja letrare në gjysmën e dytë të shekullit XX.</li> <li>- Përfaqësuesit kryesorë dhe llojet letrare që preferuan të lëvronin.</li> </ul>	<p><b>Letërsia e gjysmës së dytë të shekullit XX</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton disa nga zhvillimet e reja në letërsinë e gjysmës së dytë të shekullit XX;</li> <li>- dallon përfaqësuesit kryesorë, si dhe përcakton llojet letrare që shkruanin;</li> <li>- krahason letërsinë realiste me prirjet dhe zhvillimet e reja.</li> </ul>
<p><b>Bodler</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimtaria letrare e Bodlerit.</li> <li>- Risitë që solli me veprën e tij në drejtim të motiveve dhe të shprehjes artistike.</li> <li>- Vëllimi poetik “Lulet e së keqes”.</li> </ul>	<p><b>Bodler “Lulet e së keqes”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton veprat kryesore të Bodlerit;</li> <li>- veçon risitë që solli Bodleri me veprën e tij në drejtim të motiveve dhe të shprehjes artistike;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poezitë e vëllimit “Lulet e së keqes”.</li> </ul>
<p><b>Vlerat dhe qëndrimet</b></p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përfshihet në diskutime letrare duke dhënë kontributin e tij;</li> <li>- demonstroi vëmendje, respekt dhe empati, kur të tjerët flasin;</li> <li>- shpreh interes dhe kureshtje për letërsinë;</li> <li>- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënës;</li> <li>- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;</li> <li>- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;</li> <li>- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;</li> <li>- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;</li> </ul>	

- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;
- tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.

#### **IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE**

Vitet e fundit, në praktikën e shkollës sonë flitet për metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Kështu, gjithnjë dhe më tepër po zënë vend, terma të tillë, si: mësimdhënia ndërvepruese, mësimdhënia me nxënësin në qendër, mësimdhënia e mbështetur në përdorimin e metodave për zhvillimin e mendimit kritik, puna me projekte etj.

Mësuesit të letërsisë, më shumë se çdo mësuesi tjetër, metodat dhe zhvillimet e mësipërme i japin mundësi që të zhvillojë një mësimdhënie cilësore, i krijojnë mundësi që nxënësit të lexojnë, të hulumtojnë, të krahasojnë dhe të nxjerrin përfundime për veprën letrare në të gjithë komponentët e saj.

Me mësimdhënie ndërvepruese kuptojmë përdorimin e veprimtarive që nxitin punën në grup. Bashkëpunimi i nxënësve me njëri-tjetrin në procesin e të nxënies e bën më efektiv dhe më të kënaqshëm mësimin. Pedagogjia bashkëkohore thekson faktin që nxënësit mund të mësojnë nga njëri-tjetri.

Puna me projekte është një nga format më të larta të veprimtarisë mësimore. Ajo i përfshin nxënësit në detyra me nivel të lartë kërkimor dhe hulumtues. Mësimdhënia e mbështetur në punën me projekte, kërkon nga mësuesit që t'u japin nxënësve kohën e duhur për të përgatitur projektet e tyre për çështje të caktuara me natyrë letrare. Ndërkohë, nxënësit socializohen, ndërveprojnë duke folur apo diskutuar me njëri-tjetrin, ata mësojnë të punojnë së bashku duke respektuar individualitetin e gjithsecilit dhe bëhen kompetentë të punës që ata paraqesin.

Metodat e mendimit kritik janë prezent, tashmë, në kontekstin e sotëm shkollor. Mësuesit e letërsisë duhet t'i bëjnë këto metoda pronë të punës së tyre mësimore. Përdorimi i tyre gjatë orës së mësimin u shërben nxënësve për të bërë gjykimin dhe vlerësimin e veprave dhe të autorëve duke i parë në këndvështrime dhe në qasje të ndryshme. Po kështu, ato bëjnë që nxënësit të jenë aktivë në analizën e veprave letrare dhe në mënyrë logjike t'i lidhin ato me rrethanat politike, sociale apo personale. Të parit me sy kritik bëhet, vetvetiu, pronë e nxënësve në këtë lëndë. Po kështu, metodologjia e përzgjedhur bën që studimi i veprave dhe i fragmenteve letrare sipas



periudhave, të nxjerrë në pah tiparet e veçanta të tyre dhe të zhvillojë te nxënësit të përgjithësuarit dhe nxjerrjen e konkluzioneve të qarta.

### **Parimet e mësimdhënies së lëndës së letërsisë**

Parimet që udhëheqin mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në këtë lëndë janë: angazhimi personal, vlerësimi kritik dhe lidhjet kuptimplote.

#### **Angazhimi personal**

Mësuesit:

- do të krijojnë në klasë një mjedis pozitiv, në të cilin nxënësit të diskutojnë dhe të vlerësojnë tekste të ndryshme letrare;
- do të mundësojnë që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur me tekstet, të krijojnë përshtypjet dhe gjykimet e tyre, si dhe t'i ndajnë ato me të tjerët.

#### **Vlerësimi kritik**

Mësuesit:

- do të zhvillojnë te nxënësit aftësitë për vlerësuar në mënyrë kritike tekstet letrare;
- do të nxisin nxënësit që të mbrojnë gjykimet dhe vlerësimet e tyre me shembuj dhe ilustrime nga teksti.

#### **Lidhjet kuptimplote**

Mësuesit:

- do të udhëzojnë nxënësit që të bëjnë lidhje mes teksteve letrare, mes tekstit letrar dhe jetës së tyre, si dhe mes tekstit letrar dhe botës që i rrethon;
- do të nxisin te nxënësit dashurinë për letërsinë duke u dhënë mundësinë të njihen dhe të studiojnë vepra të gjinive dhe llojeve të ndryshme nga letërsia shqipe dhe ajo botërore.

### **Kërkesa të veçanta të lëndës së letërsisë**

Mësimdhënia e letërsisë duhet të synojë zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve, në mënyrë që ata të shijojnë dhe të vlerësojnë letërsinë në mënyrë kritike. Për të realizuar këtë, mësuesit duhet të përdorin si artin, ashtu edhe shkencën e mësimdhënies. Përmbajtja e lëndës do të ketë karakter të theksuar zbatues, duke mënjanuar e minimizuar karakterin parashtrues dhe informues. Në thelb, procesi mësimor ka pasjen nga të gjithë nxënësit, pavarësisht nga dallimet e tyre në interesa, të njohurive dhe të shprehive paraprake. Ndaj, në qendër të zbatimit të programit është ballafaqimi i drejtpërdrejtë i nxënësit

me veprën, aftësimi i tij për të evidentuar vlerat, për të mbajtur një qëndrim të tijin ndaj veprës, duke shmangur kështu parashtrimin e njëanshëm të saj nga mësuesi.

Në fillim të lëndës, mësuesi duhet t'i njohë nxënësit me natyrën e zhvillimit të saj, me përmbajtjen, si dhe me çështjet që do të trajtohen. Në qendër do të jetë puna e pavarur dhe në grupe e nxënësve për të kuptuar konceptet e strategjitë bazë që mundësojnë analizën e pavarur të veprës letrare. Procesi i të nxënësve do të mbështetet shumë në hulumtimin e informacionit dhe në lirinë e përzgjedhjes e të shprehjes se mendimeve të nxënësve për autorin dhe veprën letrare.

### **a) Rolet e mësuesit**

Mësuesi është lehtësues dhe rregullator në procesin e mësimdhënies. Ai luan rol kyç për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për nxënie të pavarur. Për të realizuar misionin e tij, mësuesi:

- sqaron me nxënësve qëllimet e lëndës dhe përmbajtjen mësimore;
- krijon një atmosferë pozitive për procesin e të nxënësve;
- nxit dhe mbështet pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- përshtat mësimdhënien me interesat dhe reagimet e nxënësve;
- punon me nivele të ndryshme nxënësish dhe përshtat mësimdhënien në varësi të tyre;
- nxit cilësinë e bashkëveprimit në klasë;
- jep orientimet e duhura dhe vlerëson “kontributet” e nxënësve në procesin mësimor;
- përgatit dhe përzgjedh instrumente didaktike për aftësimin e nxënësve në analizën e pavarur të veprës letrare.

### **b) Rolet e nxënësve**

Për nxënësve, më të rëndësishme janë shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhen zhvilluar, krahasuar me një grup njohurish që duhen marrë. Mësuesi duhet të sigurojë mbështetje dhe inkurajim, në mënyrë që nxënësve të lexojnë me dëshirë vepra letrare, si dhe të gjykojnë në mënyrë kritike për to. Ata duhet të ushtrojnë imagjinatën e tyre, të reagojnë me emocion dhe të krijojnë tekstet e tyre. Për të shpjeguar qartë opinionet dhe idetë e tyre, në një punë grupi, nxënësve duhet të zhvillojnë një fjalor kritik. Ndërkohë që bëjnë kritikën e teksteve, nxënësve kanë nevojë t'u besohet, të reflektojnë dhe të jenë të gatshëm të ndajnë me të tjerët punimet e tyre me

shkrim. Nxënësit, gjatë dhe në përfundim të vitit mësimor, duhet të bëjnë përzgjedhjen e punimeve për të ndërtuar dosjen e punimeve të tyre.

## V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi korrekt dhe sistematik i nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi i nxënësve nuk ka për synim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Ai duhet të shërbejë për disa qëllime, si:

- të sigurojë informacion rreth nivelit të arritjeve të nxënësve;
- të motivojë nxënësit;
- të shënojë përparimin e nxënësve;
- të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Gjatë procesit mësimor, mësuesit:

- duhet të identifikojnë nevojat dhe mangësitë e nxënësve në procesin e të nxënësve dhe të ndjekin strategjitë dhe metodat e duhura për të përmirësuar nivelin e të nxënësve;
- duhet t'u ofrojnë nxënësve mundësi, veprimtari dhe detyra të shumta e kuptimplote, në mënyrë që të zhvillojnë dhe të demonstrojnë aftësitë dhe progresin e tyre;
- duhet t'i udhëzojnë, t'i motivojnë dhe t'i nxisin nxënësit për të përmirësuar rezultatet e tyre;
- duhet t'i qartësojnë nxënësit për qëllimin dhe kriteret e vlerësimit;
- duhet t'i përfshijnë nxënësit në procesin e vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndor. Gjatë zbatimit të programit, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi, dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë një periudhe kohore. Ai mund të përmbajë detyra me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndër-lëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërsa mësuesi, në këtë rast, rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni ose të fëmijëve të shtetasve të huaj, banues në vendin tonë, merren parasysh nga mësuesit, duke u mundësuar këtyre nxënësve që të vlerësohen me mënyra të posaçme.

Mësuesi duhet t'u komunikojë prindërve, stafit pedagogjik të shkollës, organeve shtetërore dhe palëve të tjera të interesuara, herë pas here, rezultatet e përparimit të nxënësve. Ky komunikim është mirë të jetë me shkrim dhe të përmbajë disa aspekte kryesore të punës së nxënësve, si: aftësitë, qëndrimi ndaj lëndës, pjesëmarrja në veprimtari, detyra me shkrim, sugjerime për përmirësimin e punës në të ardhmen etj.

### **Llojet e vlerësimit në letërsi**

Vlerësimi dhe mësimdhënia janë të shkruara midis tyre brenda kurrikulës, në një mënyrë të pazgjidhshme. Por, për ta përdorur vlerësimin brenda mësimdhënies në mënyrë efektive, kërkohet, mbi të gjitha, të njihet fakti se instrumente të ndryshme të tij duhet të përdoren për qëllime të ndryshme. Vlerësimet e mëposhtme janë vendimtare për arritjen e rezultateve të të nxënësve, të vendosura në lëndën e letërsisë.

**Vlerësim diagnostikues** kryhet, zakonisht, në fillim të nivelit, vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj, për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

**Vlerësimi për të nxënë** (i vazhdueshëm) është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga ky lloj vlerësimi përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Fokusi i vlerësimit nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësve.

**Vlerësimi i të nxënësve** (përmbledhës) kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet e të nxënësve përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në situata të njohura dhe të panjohura. Nëse nxënësit i zotërojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet në mënyrë të mjaftueshme, ata duhet t'i zbatojnë ato përtej materialeve të përdorura gjatë mësimdhënies. Vlerësimi i të nxënit nuk është thjesht një reflektim i njohurive të fituara, por edhe një tregues i vlefshëm dhe i besueshëm i thellësisë së të kuptuarit dhe mënyrës se si ai transmetohet dhe përgjithësohet.

Të marra së bashku, të tria llojet e vlerësimeve formojnë një hartë të plotë për përmbushjen e rezultateve të të nxënit, e cila përfshin pikën e nisjes, rrugën që duhet ndjekur dhe pikëmbërritjen.

## **VI. ELEMENTET QË DO TË STUDIOHEN NË TEKSTET LETRARE**

Elementet e ndryshme që do të studiohen në veprat letrare, janë ato elemente që e karakterizojnë tekstin letrar, si të tillë. Ato janë përshkruar më poshtë dhe renditja e tyre nuk është bërë sipas rëndësisë ose shkallës së vështirësisë. Ato nuk duhen studiuar të izoluara ose të ndara nga njëra-tjetra, por të gjitha së bashku. Kështu, ato krijojnë një kornizë brenda së cilës nxënësit nxiten për të interpretuar, analizuar, reflektuar dhe vlerësuar tekstet letrare.

Natyrisht, këto elemente mund të mos jenë të pranishme në të gjitha tekstet letrare me të cilat do të njihen nxënësit, si p.sh., në një poezi nuk mund të diskutosh për personazhet dhe tiparet e tyre. Ato janë:

### **- Fabula dhe subjekti**

Me fabul dhe subjekt kuptohen ngjarjet ose ndodhitë brenda një teksti, si dhe lidhja me njëra-tjetrën.

### **- Personazhet**

Nxënësit analizojnë dhe vlerësojnë personazhet, mënyrën se si ata prezantohen, veprimet e tyre, marrëdhëniet me personazhet e tjera, cilësitë emocionale, morale, sociale dhe intelektuale.

### **- Koha, vendi, rrethanat dhe atmosfera**

Nxënësit duhet të diskutojnë për kohën dhe mjedisin ku zhvillohen ngjarjet në një tekst letrar, si dhe për kontekstin ku vendosen ato. Atmosfera ka të bëjë me gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat.


### **- Tematika**

Me tematikë kuptohet çështja/çështjet kryesore që trajtohen në një tekst letrar.

## - Stili dhe gjuha

Me stil kuptohet përdorimi i qëllimshëm i gjuhës nga ana e shkrimtarit, me qëllim që të arrijë efekte të caktuara. Gjuha ka të bëjë me përdorimin e qëllimshëm të një ligjërimi apo leksiku të orientuar nga tematika apo qëllimi i autorit.

Diagrami i mëposhtëm pasqyron lidhjen mes këtyre elementeve.



## 1. Autorët dhe veprat e sugjeruara në arsimin e mesëm e lartë

Në tabelën e mëposhtme janë sugjeruar disa autorë dhe vepra letrare që do të studiohen përgjatë tri viteve. Këto vepra duhet të lexohen të plota nga nxënësit. **Analiza dhe studimi i këtyre veprave (së bashku me autorin) sugjerohet të zhvillohen në jo më pak se 5 orë mësimi.**

Mësuesit janë të lirë që përveç këtyre autorëve dhe veprave të punojnë me nxënësit edhe autorë ose vepra të tjera të këtyre periudhave ose të letërsisë bashkëkohore shqipe dhe botërore. Këto mund të realizohen në trajtën e projekteve ose të bisedave letrare.

NR	KLASA X	KLASA XI	KLASA XII
	<b>Folklor</b> <b>Antikiteti –Shekulli XVIII</b>	<b>Letërsia e shekullit XIX</b>	<b>Letërsia e shekullit XX</b>
1.	<b>Cikli i kreshnikëve</b>	<b>Gëte</b> “Fausti”	
2.	<b>Homeri</b> “Iliada”	<b>Hygo</b> “Katedralja e Parisit”	
3.	<b>Eskili</b> “Prometeu i mbërthyer”	<b>Bajron</b> “Shtegtimet e Çajld Harold”	
4.	<b>Euripidi</b> “Medea”	<b>De Rada</b> “Këngët e Milosaos”	
5.	<b>Aligeri</b> “Ferri”	<b>N. Frashëri</b> “Lulet e verës”	
6.	<b>Barleti</b> “Histori e Skënderbeut”	<b>Balzak</b> “Xha Gorio”	
7.	<b>Bogdani dhe Budi</b> “Këngët e sibilave” dhe disa poezi të Budit	<b>Flober</b> “Zonja Bovari”	
8.	<b>Servantes</b> “Don Kishoti i Mançës”	<b>Dostojevski</b> “Vëllezërit Karamazovë”	
9.	<b>Shekspiri</b> “Hamleti”	<b>Bodler</b> “Lulet e së keqes”	
10.	<b>Molieri</b> “Tartufi”		

## **2. Leximet jashtë klase dhe bisedat letrare**

Përveç veprave të detyrueshme për t'u lexuar, këshillohet që, brenda një viti shkollor, të studiohen edhe 1-2 vepra për projekte ose biseda letrare. Orët për projekte ose biseda letrare, mësuesit duhet t'i vendosin në planin e tyre mësimor, kur të bëjnë zbërthimin analitik të programit. Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve t'u krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.

**Veprat e rekomanduara për projekte ose biseda letrare duhet të jenë:**

- nga letërsia shqipe dhe nga letërsia botërore;
- nga autorë të periudhave të ndryshme;
- nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e projekteve ose e bisedave letrare nga autorë të ndryshëm, periudha të ndryshme, nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare së nxënësve. Këto vepra duhet të jenë brenda listave rekomanduese të MAS-it.

## **VII. MATERIALET, BURIMET MËSIMORE, MJEDISËT E TË NXËNIT**

Në lëndën e letërsisë, për arritjen e kompetencave, është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe i materialeve të shumta mësimore, për të krijuar mundësi që nxënësit të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: tekstet shkollore (të shtypura dhe digjitale), veprat letrare (veprat letrare mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës), revistat, atlaset, enciklopeditë, antologjitë, televizori, videoprojektori, kompjuteri, interneti, CD-të etj.

Pjesa më e madhe e orëve të mësimin zhvillohet në klasë, ku mundësohen punët në grupe, dramatizimet, tryezat e rumbullakëta. Gjithashtu, gjatë vitit mësimor nxënësit mund të shkojnë në biblioteka, të marrin pjesë në panairë të librit, të shkojnë në teatër ose kinema, të zhvillojnë takime me shkrimtarë, të vënë në skenë një pjesë dramatike etj.